



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**Anr.1033/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin Valdete Feka, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.1033/2021, paraqitur nga Valdete Feka, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin kanë kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 03/L072.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga Valdete Feka, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate me të cilën pretendon se në vendvotimin 03/L072 i mungojnë votat e votuesve të tij. Në mbështetje të pretendimeve të tij nuk ka paraqitur asnjë dëshmi si provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Valdete Feka, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Ferizajit, nga Subjekti Politik Nisma Social Demokrate, me të cilën ka kërkuar që të bëhet rinumërimi në Vendvotimin 03/L072, në Komunën e Ferizajit është i pabazuar pasi që Paneli vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse e as nuk e ka precizuar vendvotimin e saktë lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur,

edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e tij nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkrete por janë vetëm pretendime të supozuara andaj këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Kështu që Paneli vlerësoi se apeli nuk është i bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.1033/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesues i Panelit  
Burim Ademi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.